

Karakteristikat e nxënësve që kryejnë sjellje agrersive dhe/ose bullizëm:

- Kryejnë keqtrajtime fizike dhe /ose verbale ndaj të tjerëve, duke rritur numrin e incidenteve të raportuara tek të tjerët
- Angazhohen në sjellje ngacmuese, kërcënuese dhe dhunuese
- Vazhdimisht godasin, fyejnë apo shtyjnë të tjerët
- Shfaqin zemërim të fortë
- Humbasin lehtësisht durimin
- Kanë shpërthime inati
- Karakterizohen nga nervozizmi ekstrem
- Kanë sjellje ekstreme impulsive
- Frustrohen lehtësisht
- Dëmtojnë ose ndërveprojnë në mënyrë të papërshtatshme me të tjerët gjatë lojës, kohës së lirë apo orës mësimore
- Nxisin dhe përfshihen në konflikte të vazhdueshme, debate dhe përplasje
- Perceptohen nga të tjerët si individë që duhen shmangur
- Mohojnë lëndimet që iu shkaktojnë të tjerëve
- Nuk shfaqin ndjenja faji, keqardhje apo shqetësim për sigurinë dhe mirëqenien e të tjerëve
- Shfaqin agresionin relacional duke nisur thashetheme, duke pozicionuar kolegët ndaj njëri-tjetrit, duke fajësuar të tjerët, duke i kthyer grupet e shokëve ndaj një individi etj.
- Shfaqin gjuhë kërcënuese të trupit
- Nuk respektojnë rregullat, disiplinën apo autoritetin
- Kanë mungesë të frikës për t'u lënduar,
- Angazhohen në përplasje dhe konflikte të shpeshta
- Kanë dëshirë të perceptohen si individë që anagazhohen në konflikte dhe përplasje